



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. 4619 Prot
10

Shkodër, më 17.11 .2023

**KONTRATË SIPËRMARRJE SHËRBIMI
REF-84368-10-19-2023**

Shërbime për riparime dhe mirëmbajtje të godinave administrative

E lidhur sot me datë 17/11 /2023, midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkoder, e përfaqësuar nga **Z. Benet Beci** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Shkoder i përfaqësuar ne kete kontrate me Vendim Delegimi nr. 325 date 02.10.2023 nga **Z. Onid Bejleri** në cilësinë e Zv/Kryetarit të Bashkisë Shkoder që në vijim do të quhet **Autoriteti Kontraktor**.

Operatori ekonomik **"MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE"** sh.p.k, regjistruar me regjistrim fillestar me nr. CN-111685-01-08, me licencë profesionale të shoqërisë nr. NZ. 7077/16, dt. 24.08.2023 me vlefshmeri te licenses pa afat kohor lëshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë me seli të shoqërisë: Rruga e Durrësit, Hyrja Nr. 3, Pasuri e llojit njësi Nr.4/12+3-B/1, Zona Kadastrale 8210, Tiranë, me NUIS **K81314023A**, e përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë **Z. Benard Martini** me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe kompetencë të plotë për të përfaqësuar shoqërinë, në të gjitha marrdhëniet që burojnë prej kësaj kontrate me autoritetin Kontraktor, Bashkia Shkodër për realizimin e objektit të kontratës. Në vijim do të quhet **"Kontraktuesi"**

Neni 1

Baza ligjore

- Kodi Civil ligji nr.7850, dt. 29.07.1994, i ndryshuar,
- Ligji Nr. 162, dt. 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik"
- VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar
- Ligji nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e tregtare", i ndryshuar,
- Udhëzimit nr. 30, dt. 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".



Neni 2

Objekti i kontratës

- 2.1. Objekt i kësaj kontrate është shërbimi me objekt: **“Shërbime për riparime dhe mirëmbaje të godinave administrative”** në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të dhëna në dokumentat e tenderit dhe që **Kontraktuesi – “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” sh.p.k** pranon t'i realizojë sipas ofertës së ofruar dhe pranuar si fituese në procedurën e prokurimit.

Neni 3

Vleftha e kontratës

- 3.1. Kontraktuesi merr përsipër të kryejë të gjitha shërbimet tek Autoriteti Kontraktor sipas objektit të lartpërmendur në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të dhëna në dokumentat e tenderit, kundrejt një vlere prej **2,778,310** (dy milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e treqind e dhjetë) lekë pa tvsh dhe **3,333,972** (tre milion e treqind e tridhjetë e tremijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë me tvsh.
- 3.2. Financimi realizohet nga Buxheti Bashkisë viti 2023 i miratuar me VKB Nr. 71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023 - 2025 të Bashkisë së Shkodrës”.
- 3.3. Çmimet e kontraktorit për shërbimet e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Neni 4

Afati i kontratës

- 4.1 Kontrata do të realizohet 35 (tridhjetë e pesë) ditë nga data e nënshkrimit të procesverbalit të fillimit të shërbimit.

Neni 5

Gjuha e kontratës

- 5.1 Gjuha e kontratës është gjuha shqipe.

Neni 6

Qëllimi

- 6.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 6.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 6.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik.



Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

- 6.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 6.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 7 Përkufizime

7.1 Kontrata

- "Kontrata" do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.
- "Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.
- "Çmimi i Kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet Furnizuesit siç specifikohet në kontratë.
- "Përfundimi" do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitet, nga Furnizuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.
- "Ndërprerje e Kontratës" do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në Nenin 23.
- "Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e Shërbimeve objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.
- "Termet e Referencës" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.
- "Listat" do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuara nga Furnizuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë. Dokumente të tilla mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.
- "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Furnizuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.
- "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

7.2 Palët e Kontratës

- "Palë" do të thotë nënshkruesit e kontratës, në cilësinë e Blerësit dhe Furnizuesit sipas kontekstit.
- "Blerës" do të thotë Autoriteti Kontraktor përfituesi i Shërbimeve objekt kontrate.



- "Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për kryerjen e një pjese të Shërbimeve.

7.3 Llogaritja e afateve

- "Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.

7.4 Shërbimet

- "Shërbime" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Furnizuesi sipas Kontratës.

7.5 Përkufizime të tjera

- "Adresa e Blerësit" është adresa e specifikuar në KVK.
- "Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 20 "Forca Madhore".
- "Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 11 "Sigurimi i Kontratës".
- "Vendi i kryerjes së Shërbimeve", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.
- "E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektivist e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE.
- Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 21.
- "Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe për zbatim të LPP –së siç specifikohet në KVK.
- "Praktikat e Ndalura" kanë kuptimin e përcaktuar në LPP.

7.6 Interpretimi

Interpretimi i Kontratës, përveç kur konteksti kërkon ndryshe:

- (a) fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë;
- (b) fjalët që tregojnë njëjësin përfshijnë edhe shumësin dhe fjalët që tregojnë shumësin përfshijnë edhe njëjësin;
- (c) dispozitat që përfshijnë fjalën "bie dakord", "rënë dakord" ose "marrëveshje" kërkojnë që marrëveshja të dokumentohet me shkrim;
- (d) "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shkruar me makinë, printuar ose i bërë në mënyrë elektronike.

7.6.1 Modifikimi

Çdo modifikim i Kontratës i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht Kontratës dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm. Palët nuk mund të bëjnë modifikime të asnjë elementi të kontratës që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet mbi bazën e të cilave është përzgjedhur Furnizuesi.



7.6.2 Heqja dorë

Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë dorëheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën nga e cila po hiqet dorë.

7.6.3 Ndikimi i pavarur i dispozitave të kontratës

Nëse ndonjë dispozitë ose kusht i Kontratës është i ndaluar ose bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, një ndalim, pavlefshmëri apo pazbatueshmëri e tillë nuk ndikon në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite dhe kushti tjetër të Kontratës.

7.7 Komunikimet

Kurdo këto Kushte parashikojnë dhënien ose lëshimin e miratimeve, certifikatave, pëlqimeve, përcaktimeve, njoftimeve, kërkesave dhe shlyerjeve këto komunikime do të jenë:

(a) me shkrim dhe të dorëzuara dorazi (kundrejt marrjes), dërguar me postë ose korrier, ose transmetuar duke përdorur ndonjë nga sistemet e rena dakord të transmetimit elektronik siç përshkruhet në KVK;

Dhe

(b) dorëzuar, dërguar ose transmetuar në adresën për komunikimet e marrësit siç përshkruhet në KVK. Sidoqoftë:

(i) nëse marrësi njofton një adresë tjetër, komunikimet do të dorëzohen në përputhje me rrethanat; dhe

(ii) nëse marrësi nuk ka deklaruar ndryshe kur kërkon një miratim ose pëlqim, mund të dërgohet në adresën nga e cila është lëshuar kërkesa.

Miratimet, pëlqimet dhe përcaktimet nuk do të mbahen ose vonohen pa arsye.

7.8 Ligji dhe gjuha

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Gjuha e Kontratës do të jetë ajo e deklaruar në KVK.

Gjuha për komunikime do të jetë ajo e deklaruar në KVK. Nëse aty nuk përcaktohet asnjë gjuhë, gjuha për komunikime do të jetë gjuha e përcaktuar e Kontratës.

Dokumentet mbështetëse dhe literatura e shtypur që janë pjesë e Kontratës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse dhe, për qëllime të interpretimit të Kontratës, ky përkthim do të mbizotërojë.

Furnizuesi do të përballojë të gjitha kostot e përkthimit dhe të gjitha risqet e saktësisë së një përkthimi të tillë, për dokumentet e siguruar nga Furnizuesi.



7.9 Prioriteti i Dokumenteve

Dokumentet që formojnë Kontratën duhet të konsiderohen reciprokisht shpjeguese të njëri-tjetrit. Nëse në dokumente gjendet një paqartësi ose mospërputhje, Blerësi lëshon çdo sqarim ose udhëzim të nevojshëm.

7.10 Hartimi i Kontratës

7.10.1 Njoftimi i ofertës fituese në përfundim të afateve të ankimit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.

7.10.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës.

7.11 E drejta e autorit

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha dokumentet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe informacione të dhëna Blerësit nga Furnizuesi këtu do t'i mbeten Blerësit, edhe nëse ato i janë furnizuar Blerësit drejtpërdrejt ose përmes Furnizuesit nga ndonjë pale të tretë, përfshirë furnizuesit e materialeve.

7.12 Detaje Konfidenciale

Furnizuesi dhe personeli i Blerësit do të zbulojnë çdo informacion të tillë konfidencial dhe informacione të tjera që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme për të verifikuar pajtueshmërinë e Furnizuesit me Kontratën dhe për të lejuar zbatimin e duhur të saj.

Secili prej tyre do t'i trajtojë të dhënat e kontratës në mënyrë konfidenciale, deri në masën e nevojshme për të kryer detyrimet e tyre përkatëse sipas Kontratës ose për të qenë në përputhje me ligjet në fuqi. Asnjë prej tyre nuk do të publikojë ose zbulojë të dhëna të veçanta të Shërbimeve të përgatitura nga Pala tjetër pa marrëveshjen paraprake të Palës tjetër. Sidoqoftë, Furnizuesit lejohen të zbulojnë çdo informacion publikisht të disponueshëm, ose informacion që kërkohet për të provuar kualifikimet e tij për të konkurruar në procedura të tjera.

Pavarësisht nga sa më sipër, Furnizuesi mund t'i sigurojë Nënkontraktorit (eve) të tij dokumente, të dhëna dhe informacione të tjera që merr nga Blerësi në masën e kërkuar që Nënkontraktori (ët) të kryejë punën e tij sipas Kontratës. Në rast të tillë, Furnizuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me Nënkontraktorin/ët një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit sikurse parashikohet në adresë të Furnizuesit sipas këtij neni.

7.13 Pajtueshmëria me ligjet

Gjatë realizimit të Kontratës Furnizuesi respekton ligjet në fuqi.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në Kushtet e Veçanta:



(a) Blerësi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe/ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që (i) autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Blerësit të sigurojë në emër të tij dhe (ii) janë të domosdoshëm për ekzekutimin e Kontratës, përfshirë ato që kërkohen për përmbushjen e detyrimeve përkatëse si nga Furnizuesi ashtu dhe Blerësi sipas Kontratës;

(b) Furnizuesi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Furnizuesit të sigurojë në emër të tij dhe që janë të nevojshme për kryerjen e Kontratës, duke përfshirë, pa u kufizuar, vizat për personelin e Furnizuesit dhe Nënkontraktorit dhe lejet e hyrjes për të gjitha pajisjet e importuara të Furnizuesit. Furnizuesi siguron të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat e tjera që nuk janë përgjegjësi e Blerësit sipas pikës (a) të këtij neni këtu dhe që janë të nevojshme për ekzekutimin e Kontratës. Furnizuesi do të dëmshpërblejë dhe zhdëmtojë Blerësin nga dhe kundër çdo dhe të gjitha detyrimeve, dëmeve, pretendimeve, gjobave, penaliteteve dhe shpenzimeve të çfarëdo natyre që lindin ose rezultojnë nga shkelja e ligjeve të tilla nga Furnizuesi ose personeli i tij, duke përfshirë Nënkontraktorët dhe personelin e tyre, por pa çënuar Nenin 9.1.

7.14 Përgjegjësia e përbashkët dhe solidare

Nëse Furnizuesi është një bashkim i Operatorëve Ekonomikë, të gjithë këta Operatorë Ekonomikë do të jenë bashkërisht dhe solidarisht përgjegjës ndaj Blerësit për përmbushjen e dispozitave të Kontratës.

7.15 Inspektimet dhe Auditimi nga Blerësi

Furnizuesi i përgjigjet pyetjeve dhe i jep Blerësit çdo informacion ose dokument të nevojshëm për (i) hetimin e pretendimeve të Praktikave të Ndaluar, ose (ii) monitorimin dhe vlerësimin nga ana e Blerësit të Kontratës dhe për t'i dhënë mundësi Blerësit të shqyrtojë dhe adresojë çdo problematikë në lidhje me Kontratën.

Furnizuesi mban të gjithë dokumentacionin në lidhje me zbatimin e Kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 8

Hartimi i Kontratës

8.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.

8.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 9

Praktikat e Ndaluar



- 9.1 Furnizuesi nuk /do të autorizojë ose lejojë asnjë nga punonjësit ose përfaqësuesit e tij, të angazhohen në Praktika të Ndaluar në lidhje me prokurimin, dhënien ose ekzekutimin e Kontratës.
- 9.2 Nëse Blerësi konstaton se dhënia e kontratës është bërë në kushtet e konfliktit të interesit dhe ky fakt nuk ka qenë i mundur të identifikohet më parë, i kërkon Komisionit të Prokurimit Publik të deklarojë kontratën absolutisht të pavlefshme.
- 9.3 Nëse Blerësi gjatë zbatimit të kontratës ka informacion për veprime korruptive informon organet kompetente.

Neni 10

Njoftimet

- 10.1 Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tek tjetra, në përputhje me Kontratën, do të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në KVK.
- 10.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 11

Objekti i Furnizimit

- 11.1 Mallrat dhe Shërbimet e Lidhura me to që do të furnizohen duhet të jenë sipas specifikimeve dhe kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.
- 11.2 Kushtet e kontratës nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur Furnizuesi, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

Neni 12

Dorëzimi

- 12.1 Dorëzimi i Mallrave dhe Përfundimi i Shërbimeve të Lidhura me to do të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit.

Neni 13

Përgjegjësitë e Furnizuesit

- 13.1 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për furnizimin e të gjitha Mallrave dhe Shërbimeve të Lidhura me to të përfshira në Objektivin e Furnizimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Neni 14

Çmimi i Kontratës



- 14.1 Çmimi i kontratës do të jetë i pandryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së realizimit të Kontratës, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 21.

Neni 15

Kushtet e Pagesës

- 15.1 Çmimi i Kontratës do të paguhet siç specifikohet në KVK.
Furnizuesi duhet të paguhet nga Blerësi për Mallrat e dorëzuara dhe Shërbimet e Lidhura me to të kryera, në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në Kontratë.
- 15.2 Pagesat do të kryhen menjëherë nga Blerësi, jo më vonë se periodha kohore e specifikuar në KVK pas dorëzimit të një fature ose kërkesë për pagesë nga Furnizuesi, dhe pasi Blerësi ta ketë pranuar atë.
- 15.3 Nëse nuk përcaktohet ndryshe në KVK, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës.
- 15.4 Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Blerësit, megjithëse Furnizuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

Neni 16

Sigurimi i Kontratës

- 16.1 Furnizuesi, brenda afatit të caktuar nga Blerësi në njoftimin e fituesit, paraqet Sigurimin e Kontratës në shumën e specifikuar në KVK.
- 16.2 Në përputhje me Nenin 10.1, Sigurimi i Kontratës do të shprehet në monedhën e Kontratës dhe do të jetë në formën e përcaktuar nga Blerësi në KVK.
- 16.3 Shuma nga Sigurimi i Kontratës do t'i paguhet Blerësit si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga mospërmbushja e detyrimeve sipas Kontratës nga ana e Furnizuesit.
- 16.4 Sigurimi i Kontratës do t'i kthehet Furnizuesit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së përmbushjes së detyrimeve së Furnizuesit sipas Kontratës, përfshirë çdo detyrim garancie, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në KVK.

Neni 17

Nënkontraktimi

- 17.1 Nënkontraktimi nuk duhet të bëhet pa aprovimin paraprak me shkrim të Blerësit dhe jo më shumë se 50% të vlerës së kontratës.
- 17.2 Blerësi lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për furnizimet që do të kryejë, me miratimin paraprak me shkrim të Furnizuesit

17.3 Parashikimet e Nenit 2 zbatohen edhe për nënkontraktimin.

Neni 18

Specifikime dhe Skicime

- 18.1 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Furnizuesi duhet të përgatisë të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranura dhe të njohura në përgjithësi të pranueshme për Blerësin dhe të marrë parasysh standartet më të fundit.
- 18.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Furnizuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjëse përsa i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

Neni 19

Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

- 19.1 Furnizuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Blerësin për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.
- 19.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Furnizuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

Neni 20

Dëmet e likujduara

- 20.1 Dëmet e likujduara për kryerjen e vonuar të shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:
- a) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së Kontratës.
- b) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.
- c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

Neni 21

Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor

- 21.1 Furnizuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Blerësi përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Furnizuesit.




- 21.2 Furnizuesi do të zëvendësojë çdo punonjës nëse Blerësi zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Blerësi është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.
- 21.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Furnizuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.
- 21.4 Furnizuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkaku i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Blerësit.

Neni 22

Zhdëmtimi i Patentës

- 22.1 Furnizuesi dëmshpërblen dhe zhdëmton Blerësin dhe zyrtarët e tij nga dhe kundër padive, veprimeve ose procedurave administrative, pretendimeve, kërkesave, humbjeve, dëmeve, kostove dhe shpenzime të çdo natyre, përfshirë tarifat e avokatit dhe shpenzimet, të cilat Blerësi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që përndryshe ekzistonte në datën e kontratës për shkak të:
- (a) ofrimit të shërbimeve nga Furnizuesi ose përdorimit të shërbimeve në vendin e dorëzimit të Shërbimeve;
- dhe
- (b) shitjen në çdo vend të produkteve të prodhuara nga Shërbimet.
- Një zhdëmtim i tillë nuk aplikohet nëse Shërbimet ose ndonjë pjesë e tyre përdoren përtej kushteve të kontratës ose përdorimi i tyre ose i një pjese të tyre bëhet në kombinim me ndonjë pajisje, impiant ose material tjetër që nuk është furnizuar nga Furnizuesi, në përputhje me Kontratën.
- 22.2 Nëse është nisur ndonjë procedurë apo ngritur ndonjë kërkesë kundër Blerësit që del nga çështjet e përmendura në Nenin 15.1, Blerësi do të njoftojë menjëherë Furnizuesin, dhe Furnizuesi mundet me shpenzimet e tij dhe në emër të Blerësit të ndërmarrë të gjitha veprimet për zgjidhjen e ndonjë procedure apo pretendimi të tillë.
- 22.3 Nëse Furnizuesi nuk e njofton Blerësin brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së një njoftimi të tillë, atëherë Blerësi do të jetë i lirë të kryejë të njëjtën gjë në emër dhe për llogari të tij.
- Blerësi, me kërkesën e Furnizuesit, do ti japë Furnizuesit të gjithë ndihmën në dispozicion në kryerjen e procedurave të tilla dhe do të rimbursohet nga Furnizuesi për të gjitha shpenzimet e arsyeshme të kryera në këtë mënyrë.
- Blerësi dëmshpërblen dhe zhdëmton Furnizuesin dhe punonjësit, dhe nënkontraktorët e tij nga dhe kundër çdo padie, veprimi apo procedure administrative, që Furnizuesi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori



ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që ekzistonte në datën e kontratës që lind nga ose në lidhje me çdo skicim, të dhënë, vizatim, specifikim apo dokument apo materiale të tjera të ofruara apo skicuara nga ose në emër të Blerësit.

Neni 23

Kufizimi i Përgjegjësisë

- 23.1** Me përjashtim të rasteve të neglizhencës së rëndë ose shkelje me dashje:
- (a) Furnizuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Blerësit, për ndonjë humbje apo dëm indirekt ose që ka si pasojë, humbje të përdorimit, humbje të prodhimit, ose humbje të fitimeve ose kostove të interesit, me kusht që ky përjashtim të mos zbatohet për asnjë detyrim të Furnizuesit për t'i paguar Blerësit dëmet e likujduara; dhe
 - (b) përgjegjësia e përgjithshme e Furnizuesit ndaj Blerësit, nuk duhet të kalojë Çmimin e Kontratës, me përjashtim të rasteve për koston e dëmeve të rezultuara nga gabimet ose mangësitë në kryerjen e shërbimeve, ose çdo detyrim të Furnizuesit për të zhdëmtuar Blerësin në lidhje me shkeljen e patentës.

Neni 24


Ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjorë

- 24.1** Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Furnizuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 25

Forca madhore

- 25.1** Mos kryerja apo kryerja me vonesë nga ana e një Pale të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate nuk do të konsiderohet shkelje e kësaj Kontrate nëse një mospërmbushje apo vonesë e tillë vjen drejtpërdrejt për shkak të ndonjë ngjarje të Forcës Madhore.
- 25.2** Për qëllime të këtij neni, "Ngjarja e Forcës Madhore" do të thotë një ngjarje ose situatë përtej kontrollit të një Pale që nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe nuk shkaktohet nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit nga njëra Palë. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, veprime të një Pale qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmytjet, epidemitë/pandemitë, kufizimet e karantinës dhe embargo e mallrave.
- 25.3** Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore, Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga Pala tjetër me shkrim, Pala e prekur do të vazhdojë të kryejë



detyrimet e saj sipas Kontratës për aq sa është e arsyeshme e praktikueshme dhe do të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen nga Ngjarja e Forcës Madhore

Neni 26

Modifikimi i Kontratës

- 26.1** Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.
- 26.2** Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për përlogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.
- 26.3** Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Blerësit, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Furnizuesit dhe Blerësit.

Neni 27

Zgjatja e afatit

- 27.1** Nëse në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Kontratës, Furnizuesi ose nënkontraktorët e tij hasin kushte që pengojnë kryerjen në kohë të Shërbimeve në përputhje me Nenin 5, Furnizuesi njofton menjëherë Blerësin me shkrim për vonesën, kohëzgjatjen e mundshme dhe shkakun e saj. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit të Furnizuesit, Blerësi vlerëson situatën dhe në bazë të diskrecionit të tij mund të zgjasë kohën e realizimit nga ana e Furnizuesit. Në këtë rast zgjatja miratohet nga Palët dhe reflektohet në modifikimin e Kontratës.
- 27.2** Me përjashtim të rastit të Forcës Madhore, siç parashikohet në Nenin 20, një vonesë nga Furnizuesi në kryerjen e detyrimeve të Dorëzimit dhe Përfundimit do ta bëjë Furnizuesin përgjegjës për pagesën e dëmeve të likujduara në përputhje me parashikimet në kontratë.

Neni 28

Ndërprerja e Kontratës

- 28.1** **Njoftim për të korrigjuar**
Nëse Furnizuesi nuk përmbush ndonjë detyrim sipas Kontratës, Blerësi mund të kërkojë me Njoftim që Furnizuesi të ndreqë mospërmbushjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.
- 28.2** **Ndërprerja për mospërmbushje**



Blerësi, pa cenuar ndonjë mjet tjetër ligjor në lidhje me shkeljen e Kontratës, mundet me anë të një Njoftimi me shkrim për mospërbushje që i dërgohet Furnizuesit, ta përfundojë Kontratën në tërësi ose pjesërisht:

- (i) nëse Furnizuesi nuk ka përbushur detyrimin edhe pas Njoftimit të bërë sipas pikës 23.1 të këtij neni;
- (ii) Nëse Furnizuesi nuk ka arritur të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në Kontratë, ose brenda ndonjë zgjatjeje të dhënë nga Blerësi në përputhje me Nenin 22; ose
- (iii) Nëse provohet se Furnizuesi është angazhuar në Praktika të Ndaluara, siç përcaktohet në Nenin 2, gjatë konkurrimit për Kontratën apo ekzekutimit të saj.

28.3 Ndërprerja për paaftësi paguese

Blerësi ndërpret në çdo kohë Kontratën duke njoftuar Furnizuesin nëse Furnizuesi falimenton. Furnizuesi ndërpret në çdo kohë Kontratën nëse Blerësi nuk ka aftësi paguese. Në një rast të tillë, ndërprerja do të bëhet pa kompensim për Furnizuesin, me kusht që kjo ndërprerje nuk do të cenojë ose ndikojë në ndonjë të drejtë padie apo mjeti ligjor që ka lindur apo do të lindë më pas për Blerësin.

28.4 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

a) Blerësi mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

b) Blerësi duhet të njoftojë me shkrim Furnizuesin për ndërprerjen.

c) Blerësi duhet të paguajë Furnizuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Furnizuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Furnizuesit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 29

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

29.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore përmes bisedimeve të drejtpërdrejta çdo mosmarrëveshje që lind midis tyre gjatë ekzekutimit të Kontratës.


29.2 Nëse, palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me një konsultim të tillë të ndërsjellë, atëherë secila Palë mund t'i njoftojë Palës tjetër për qëllimin e saj për të shkuar në Gjykatë.

Neni 30

Përfaqësimi i Palëve

30.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukture organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.

- a) Personat që do të jenë përgjegjës, në emër të **Autoritetit Kontraktor** për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës do të jenë:
Ing. Florinda Hilaj me detyre specialiste pranë Drejtorisë Ekonomike të Arsimit
Ing. Elsid Sadiku me detyre specialist pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Ndjkejes së Investimeve të Infrastrukturës
 cel/tel/fax +355 692061724; +355 693810646
 E-mail: shepbimetpublike@bashkiashkoder.gov.al
- b) Personi që do të jetë përgjegjës në emër të **Kontraktuesit** për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës do të jete **Ing. Albion Kadriu**.
 Cel/tel/fax +355 682077724
 E-mail: info@martinikonstruksion.al
- 30.2** Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 30.3** Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.
- 30.4** Në zbatim të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", kreu XIII, neni 107, pika 6, "Zbatimi dhe mbikqyerja e kontratës", në përfundim të kontratës, **Ing. Florinda Hilaj** dhe **Ing. Elsid Sadiku** si personat që do të jenë përgjegjës, në emër të Autoritetit Kontraktor për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës do të përgatisin një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit të kontratës dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti paraqet një informacion për likudimin ose jo të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.
- 30.5** Personi përgjegjës duhet të ndjekë me përpikëri ecurinë e zbatimit të kontratës, për t'u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës. Personi përgjegjës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi:
- harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës;
 - kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë;
 - administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë dhe afateve, kur është rasti;
 - menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/ modifikime/ përshtatje të saj;
 - raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor për shkelje të dispozitave kontraktuale;



- e) administron kërkesat për ndryshime/ modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;
- ë) mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës;
- f) përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së

Neni 31

Lajmërimet

- 31.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.
- 31.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 32

Llogaritja e Afateve

Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

Neni 33

Vlefshmeria e kontratës

- 33.1 Kjo kontratë u hartua ne gjashtë kopje origjinale, pese per Autoritetin Kontraktor dhe nje per Kontraktuesin, dhe pasi u lexua, firmoset rregullisht nga palet
- 33.2 Kjo kontratë do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

KUSHTET E VEÇANTA TË KONTRATËS

Kushtet e mëposhtme të veçanta të Kontratës do të plotësojnë KPK. Nëse ka një konflikt, dispozitat e KVK do të mbizotërojnë mbi ato në KPK.

Neni 1

Dispozitat e Përgjithshme

- 1.1 Blerësi është: **Bashkia Shkodër**
Adresa: Rr. "13 dhjetori", Nr. 1 Shkodër
Telefoni: +355 22400150
Numri i faksit: _____
E-mail: info@bashkiashkoder.gov.al
- 1.2 Furnizuesi është: **"MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE"**
sh.p.k.



Adresa: Rruga e Durrësit, Hyrja Nr. 3 , Pasuri e llojit njesi Nr.4/12+3-B/1,
Zona Kadastrale 8210, Tiranë

Telefoni: +355 682077724

Numri i faksit: _____

E-mail: info@martinikonstruksion.al

1.3

Gjuha për komunikimet është: **Gjuha shqipe**

Gjuha është: **Gjuha shqipe**

Neni 2

Sigurimi i Kontratës

- 2.1 Sigurimi i Kontratës në shumën prej (10% të vlerës së ofertës) duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 2.2 Sigurimi i Kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm: **30 ditë pas nënshkrimit të palëve të proçesverbalit perfundimtar të marrjes në dorëzim të shërbimit.**

Neni 3

Vendndodhja e Shërbimeve

- 3.1 Shërbimet do të kryhen sipas grafikut të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Neni 4

Fillimi i Zbatimit

- 4.1 Zbatimi i kontratës duhet të fillojë në datën që është bërë nënshkrimi procesverbalit të fillimit të shërbimit nga palët.

Neni 5

Informacion që duhet dhënë nga Bleresi

- 5.1 Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme:
 - Grafikun e shërbimit deri në perfundim të kontrates,
 - Për çdo shërbim që kërkohet sipas nevojave të Autoriteti Kontraktor, kontraktuesi do të lajmërohet me shkrim për kohën dhe vendin e shërbimit.

Neni 6

Kërkesat e Raportimit

- 6.1 Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm: Në përputhje me grafikun e realizimit të shërbimit.

Neni 7

Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale



- 7.1 Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjësisë profesionale me shumë minimale si vijon: nga data e hyrjes deri në afatin e mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion që mbulon deri në shumën prej:
- Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve.
 - Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve.
 - Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve.
 - Për dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier.

Neni 8

Kushtet e Pagesës

- 8.1 Pagesa për shërbimet pjesore apo perfundimtare, do të behet brenda 30 diteve nga dita e nënshkrimit nga palet të **“Procesverbalit/procesverbaleve pjesor apo përfundimtar të marrjes në dorëzim të shërbimit”**.
- 8.2 Administratori i Kontrates ben miratimin e pageses vetem ne rast se eshte plotesuar dokumentacioni i meposhtem:
- | | |
|---|--------------|
| Faturen/at tatimore e shërbimit, leshuar nga Kontraktuesi | (1 Original) |
| Procesverbalin/et e Marrjes në dorëzim të shërbimit | (1 Original) |
| Situacionin pjesor/perfundimtar | (1 Original) |
- Monedha e pageses do të jete: LEKE.
- 8.2 Çdo pagesë e skeduar duhet bërë brenda 30 ditëve nga data e arritjes së marrvëshjes për pagesën ose nga data e marrjes së kërkesës me shkrim për pagesë cilado që të jetë më vonë. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.
- 8.3 Monedha e pagesës do të jetë **Leke**. Nëse është lënë e paplotësuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.
- 8.4 Në zbatim të ligjit nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, fatura e leshuar nga kontraktuesi duhet të jete elektronike.
- 8.5 Të gjitha pagesat e shumave që i detyrohen Furnizuesit mund të bëhen vetëm në llogarinë bankare të Furnizuesit të detajuar në mënyrë të qartë në Kontratë.

Neni 9

Pagesa Paraprake

- 9.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë (nuk ka). Nëse nuk është specifikuar, Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.
- 9.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda (nuk ka) ditëve nga marrja e sigurimit të kontrates.
- 9.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t’i jepet Kontraktuesit sipas formulës së mëposhtme: Nuk ka

Neni 10

Çmimi i Kontratës



10.1 Çmimi i Kontratës është prej **2,778,310** (dy milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetëmijë e treqind e dhjetë) lekë pa tvsh dhe **3,333,972** (tre milion e treqind e tridhjetë e tremijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë me tvsh.

Neni 11

Shërbimet në Lidhje me to

11.1 Kushtet e veçanta të mëposhme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së shërbimeve të lidhura.

Neni 12

Zbritja e garancisë së kontratës

12.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë. Nuk parashikohet zbritje e garancise se kontrates.

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR BASHKIA SHKODËR

Kryetar

Benet BECI

Përfaqësuar me vendim delegimi

Zv. Kryetar

Onid BEJLARI

PER OPERATORIN EKONOMIK

MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” sh.p.k

Administrator ligjor

Benard MARTINI